



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2526/6 prot.

Datë 29.09.2025

V E N D I M
Nr.1347/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.09.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 2526/2025 prot., datë 17.09.2025 i operatorit ekonomik BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër”, me fond limit 180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Operatori ekonomik “BOE “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H & “Llazo” SHPK,, me NIPT K24218401K dhe adresë: Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15., Tirane..

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz, me adresë Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.07.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër”, me fond limit 180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 04.08.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 10.09.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

BOE Klajger Konstruksion & Varaku E & Bajrami	N125,083,077 lekë	Kualifikuar
BOE Meteo & TOTILA	155,177,499 lekë	Kualifikuar
BOE 2 N & Avduli	122,999,993 lekë	Skualifikuar
BOE Almo Konstruksion & Ulza	142,021,855 lekë	Kualifikuar
AMG Energy Albania	180,100,000 lekë	Skualifikuar
BOE Bonus & Fati 2010	160,272,909.6 lekë	Skualifikuar
Udha	177,253,373.6 lekë	Skualifikuar
BOE Ergi & Be – Is & 2t	134,600,835 lekë	Kualifikuar
Global Business Solutions	180,000,000 lekë	Skualifikuar
BOE Lis Konstruksion & Llazo	121,699,174.55 lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 11.09.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 17.09.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5818 dhe nr.2526/2025 prot, datë 17.09.2025 i operatorit ekonomik BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK i cili lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vleresimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2526/1, datë 18.09.2025.

II.7. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.8162/1 prot., datë 23.09.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën me nr.2526/2 prot., atë 25.09.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 8162 prot., datë 23.09.2025, të Komisionit të Shqyrtimit të ankesave, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Në datën 26.09.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues, BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, me shkresën me nr.45 prot., datë 26.09.2025, me objekt “Deklaratë tërheqje”, protokolluar me tonën me nr.2526/3 prot., datë 29.09.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës

kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër”, me fond limit 180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, duke u shprehur se:

“B.O.E "LIS KONSTRUKSION shpk me nipt K66613407H, & LLAZO shpk NIPT K24218401K kane bere ankesen me Nr. Ankimimi: A/2025/5818 dhe Datë ankese: 2025-09-17, me objekt "Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër" REF-54222-07-10-2025 prane Komisionit te Prokurimit Publik , Informojme Komisionin e Prokurimit Publik, qe per shkak te angazhimeve te stafit teknik dhe inxhinierik si dhe te makinerive qe jane te deklaruar per kete procedure, kerkojme te terhiqemi nga ankesa me nr A/2025/5818”.

II.9 Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër”, me fond limit 180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Në datën 26.09.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues, BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, me shkresën me nr.45 prot., datë 26.09.2025, me objekt “Deklaratë tërheqje”, protokolluar me tonën me nr.2526/3 prot., datë 29.09.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër”, me fond limit 180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, duke u shprehur se:

“B.O.E "LIS KONSTRUKSION shpk me nipt K66613407H, & LLAZO shpk NIPT K24218401K kane bere ankesen me Nr. Ankimimi: A/2025/5818 dhe Datë ankese: 2025-09-17, me objekt

*"Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër" REF-54222-07-10-2025 prane Komisionit të Prokurimit Publik ,
Informojme Komisionin e Prokurimit Publik, qe per shkak te angazhimeve te stafit teknik dhe inxhinierik si dhe te makinerive qe jane te deklaruar per kete procedure, kerkojme te terhiqemi nga ankesa me nr A/2025/5818".*

III.1.2. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet:

"1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes."

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. KPP konstaton se, operatori ekonomik Lis Kostruksion SHPK, i cili ka paraqitur tërheqjen nga ankesa, është paraqitur në procedurën e prokurimit objekt ankimi në cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të perkohshëm të operatorëve ekonomikë "Lis Konstruktion dhe Llazo SHPK. Referuar, nenit 3 "Përfaqësimi i palëve", të kontratës së bashkëpunimit, datë 04.08.2025, të lidhur mes shoqërisë LLazo shpk dhe shoqërisë Lis Konstruktion shpk, rezulton se shoqëria Lis Konstruktion shpk është përcaktuar si përfaqësues i këtij bashkimi të perkohshëm të operatorëve ekonomikë, e cila ndër të tjera *ka të drejtë të paraqesë kërkesa në cdo institucion si APP,KPP* Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 2526/2025 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE "Lis Kostruksion" SHPK & "Llazo" SHPK, në procedurën e prokurimit "E hapur", me nr. REF-54222-07-10-2025, me objekt: "Ndërtim Rrugët Blloku Kodër e Kuqe + Blloku Babrru Qëndër, Babrru Kodër", me fond limit

180,203,293.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 04.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

